



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 471/6 prot.

Tiranë, më 25. 09. 2023

V E N D I M

Nr. 187, datë 25. 09. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 55, datë 06.04.2023, depozituar nga ana e Shoqatës “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, Dega Gjirokastër, si përfaqëuese e O. Ç., kundër Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastër³, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *racës, ngjyrës dhe etnisë*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesja, O. Ç., në mes të tjerash informon se, prej 3 muajsh me miratimin e ish Drejtorit dhe Kryeredaktores të RTSH Gjirokastra, ka nisur përgatitjen e emisionit “Jemi edhe Ne” Pakica Egjiptiane. Emisioni në fjalë sipas ankueses, kishte të bënte me prezantimin e kulturës, traditave, zakoneve dhe problemeve me të cilat përballen pakicat kombëtare egjiptiane.

Me emërimin e drejtorit të ri, E. S., ankuesja thekson se i është ndërprerë emisioni dhe sapo ajo është përballur me të në ambientet e RTSH Gjirokastra, pretendon se ai i është drejtuar në mënyrë agresive dhe të vrazhdë, duke i kërkuar se çfarë bënte ajo në ato ambiente.

Gjithashtu, ankuesja pretendon se E. S. i ka kërkuar të mos të qëndrojë më në ambientet e RTSH Gjirokastër, si dhe i ka sqaruar se emisioni i nisur prej saj do të zhvillohej në vijim nga një gazetar i minoritetit grek, pasi ajo nuk disponon arsimin e duhur për të ushtruar profesionin e gazetares. Në

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do ti referohemi me akronimin RTSH Gjirokastër ose QVA Gjirokastër.

përballje me E. S., ankuesja pretendon se është ndier e diskriminuar për shkak të racës, ngjyrës dhe etnisë, pasi ajo i përket minoritetit egjiptian.

Në përfundim, O. Ç. kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e E. S., për shkak të racës, ngjyrës dhe etnisë, si dhe të vijojë prezantimin e emisionit të nisur “Jemi edhe ne” Pakica Egjiptiane.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, ku parashikohet: *“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”*

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 5005, datë 19.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, konstatohet se Shoqata “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin për të zhvilluar dhe integruar komunitetin egjiptian në Shqipëri.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, dega Gjirokastër, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin mbrojtjen e interesave dhe integrimin e pakicës egjiptiane në Republikën e Shqipërisë.

Mbështetur në ankesën e paraqitur Shoqata “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, dega Gjirokastrë, ajo nuk pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon diskriminim në emër të O. Ç., e cila i përket pakicës egjiptiane.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së organizatës dhe çështjes që ajo ka paraqitur në emër të O. Ç., duke vlerësuar përfundimisht se legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 471/1 prot., datë 13.04.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Këshillit Drejtues të RTSH-së, RTSH-së dhe Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastrë, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, RTSH, me shkresën⁴ Nr. 857/1 prot., datë 24.04.2023, vuri në dispozicion të Komisionerit parashtrimet sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, duke theksuar ndër të tjera se: “...Emisioni “Jemi edhe Ne” për pakicat Egjiptiane deri në datë 08.03.2023 (datë kjo në të cilën është prezantuar drejtori i ri i këtij institucioni E. S.) nuk rezulton të ketë asnjë marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, apo autorizim të saj për t’u përfaqësuar nga ankuesja O. Ç.. Gjithashtu nuk rezulton të ketë as kontratë marrëdhënie pune/punësimi ku O. Ç. të jetë në cilësinë e palës punëmarrëse apo edhe të ofrimit të shërbimit të saj në funksion të emisionit “Jemi edhe Ne”.

Ankuesja nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë projekt në lidhje me këtë format emisioni, ku të përcaktohet përmbajtja e programit (temat që do trajtohen, minutazhi, moderimi e çdo element tjetër të domosdoshëm për një program televiziv që duhet të dali në transmetim). Për rrjedhojë, duke qënë se mungon projekti për transmetimin e emisionit “Jemi edhe Ne”, mungon edhe informacioni i nevojshëm për O. Ç. (arsimimi, trajnimet, aftësitë, eksperiencat etj.).

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 471/2 prot., datë 25.04.2023.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se: me miratim të ish drejtorit dhe kryeredaktores së QVA Gjirokastër ajo kishte 3 muaj që kishte nisur përgatitjet e emisionit “Jemi dhe Ne” Pakica Egjiptiane, nga informacioni i marrë nga QVA Gjirokastër rezulton se nga verifikimi i programeve të transmetuara nga TVGJ deri në datën 09.03.2023 nuk është transmetuar asnjë emision. Dy emisione të vetme të saj janë transmetuar pa dijeninë e drejtorit, E. S..

Drejtori i QVA Gjirokastër na informon gjithashtu se ka realizuar dy takime me kërkesë të ankueses dhe përkatësisht: në datën 10.03.2023, ku O. Ç. u paraqit për të vënë në dijeni pretendimin e saj se kishte një kontratë dhe marrëveshje me ish drejtorin të cilat ndodheshin në arkivën e institucionit. E. S. sqaron në shkresën e tij të dërguar në postën elektronike të RTSH-së, qetësisht edhe aspak “në mënyrë agresive dhe të vrazhdë”, sikurse pretendon ankuesja, se do të interesohej për të gjetur dokumentacionin e dorëzuar prej saj në QVA Gjirokastër. Por pas verifikimeve në Zyrën e Financës dhe Burimeve Njerëzore, rezultoi se në arkivën e institucionit nuk ishte i depozituar asnjë nga dokumentacioni i kërkuar. Në lidhje me këtë konstatim Drejtori i QVA Gjirokastër sqaron se ka vënë në dijeni O. Ç. duke i dhënë asaj një javë kohë për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për këtë format, në mënyrë që të nisej kështu një bashkëpunim korrekt dhe brenda normave e rregullave ligjore.

Ndërkohë E. S. na informon dhe sqaron se takimi i dytë me ankuesen është bërë disa ditë më pas, kur gjatë një kontrolli rutinë të bërë nga ana e tij në orët e mbrëmjes në studion e regjistrimit, montimit dhe transmetimit, e ka gjetur O. Ç. në mjediset e brendshme të institucionit. Pa asnjë drejtë për të hyrë në institucion, në shkëlje të Rregullores së Brendshme, ajo ka qenë duke përgatitur emisionin e parë në prezencë të një montazhieri, të cilit ju tërhoq vëmendja (me gojë) për përdorimin e studios pa lejen përkatëse.

O. Ç. edhe pse ju ofrua mundësia të paraqiste një projekt së bashku me dokumentacionin përkatës, kjo në zbatim të nenit 17, paragrafi 4, “Bashkëpuntorët”, Pika 1, ku citohet: “Bashkëpuntorët – Ideojnë skenarin e emisionit dhe e paraqesin për miratim tek kryeredaktori dhe drejtori i Qendrës Vendore Audiovizive”, nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë platformë për emisionin dhe në këto kushte duhet të ndërpriste hyrjen në institucion dhe në ambientet e punës së QVA Gjirokastër.

Në lidhje me pretendimin e ankueses O. Ç. se këtë emision për Komunitetin Egjiptian do ta kryente një gazetar i emisionit në gjuhën greke, nuk është aspak e vërtetë. Ankueses i është bërë e ditur se në kuadrin e ndryshimeve programore është propozuar ngritja e Redaksisë së Diversiteteve që do të thotë se emisionet e komuniteteve do të kenë në vëmendje më të madhe, në kushtet kur në qarkun Gjirokastër jetojnë disa lloje komunitetesh. Emisioni në gjuhën greke, në bisedë është përmendur si një model i mirë, (fakt i cili është referuar për tu marrë si orientim edhe nga O. Ç. në lidhje me projektin që ajo mund të kishte ideuar) dhe aspak se emisionin e Komunitetit Egjiptian do ta përgatisë një gazetar i emisionit greqisht.

Në grilën programore të RTGJ në mënyrë të vazhdueshme janë transmetuar kronika ku pasqyrojnë aktivitete, problematika të përditshme të minoriteteve, ku një zë të rëndësishëm zënë ato Egjiptiane dhe Rome.

Për sa më sipër është sqaruar RTSH vlerëson se pretendimet e subjektit ankues O. Ç. për diskriminimin e saj për shkak të racës, ngjyrës dhe etnisë, janë pretendime aspak të vërteta, kjo pasi:

- *Funksionimi i Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastër bazohet në aktet nënligjore përkatëse ku në rastin konkret është absolutisht detyrë e ideuesit/autorit të paraqesë një projekt për një format televiziv, i cili më tej i paraqitet për miratim kryeredaktorit dhe Drejtorit të Qendrës Vendore Audiovizive, referuar nenit 17, paragrafi 4 të cituar edhe më sipër në këtë shkresë.*
- *O. Ç. gjithashtu nuk rezulton të ketë asnjë kontratë marrëdhënie pune, shërbimi apo bashkëpunimi në mënyrë që të ngrejë pretendimin e saj se është diskriminuar në ambientin e punës.*

...përsa më sipër kemi paraqitur, ne vlerësojmë se nuk jemi në kushtet e objektit të ligjit Nr. 10221/2010, i ndryshuar..., kjo pasi O. Ç. vetëm është orientuar të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me programin televiziv, Emisionin “Jemi dhe Ne” për pakicat Egjiptiane, veprim i cili nuk është kryer nga ana e ankueses. Jo vetëm kaq por ankueses i është dhënë mundësia për të paraqitur dokumentacionin për projektin në fjalë, duke qenë se në vëmendjen e RTGJ t’ju shërbejë gjithë komuniteteve që jetojnë aty dhe për këtë qëllim është vendosur edhe si prioritet i strukturës programore të RTGJ.

Vlen të theksojmë gjithashtu se O. Ç. nuk i është mohuar asnjë e drejtë apo të jetë trajtuar në mënyrë jo të barabartë, por është detyrë ligjore dhe kërkesë profesionale paraqitja e dokumentacionit të nevojshëm në mënyrë që t’i hapet rrugë bashkëpunimit mes palëve. Fakti që është konstatuar mungesë e dokumentacionit (punësimi, shërbimi, bashkëpunimi) pra konstatimi i një parregullësie, nuk përbën element diskriminimi, por është përgjegjësia e cilitdo që e konstaton, aq më tepër kur ky fakt konstatohet nga organi publik në mënyrë, që kjo të rregullohet, duke krijuar kështu një marrëdhënie juridike konkrete në përputhje me të gjitha rregullat... ”.

Me anë të e-maili-t datë 02.05.2023, Komisioneri i përcolli subjektit ankues përgjigjen e RTSH-së dhe kërkoi parashtrime me shkrim sa i përket pretendimeve të tyre. Në përgjigje të e-mail-it të sipërcituar, O. Ç. nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion shtesë.

2. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 471/3 prot., datë 13.06.2023 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 29.06.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 29.06.2023, në mungesë të palës ankuese dhe të drejtorit të RTSH Gjirokastër, të cilët megjithëse kishin dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të kësaj seance nuk u paraqitën dhe nuk paraqitën ndonjë arsye për mungesën e prezencës. Në seancë dëgjimore u paraqit RTSH, e përfaqësuar nga B. H.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Në deklarinimet e bëra gjatë seancës, RTSH mbajti të njëjtin qëndrim, si ai i komunikuar shkresërisht Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, RTSH-së iu kërkua të vërë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes informacionin si më poshtë:

- Nëse subjekti ankues ka patur më parë bashkëpunime me RTSH Gjirokastër;
 - Nëse ka patur dijeni drejtuesi i RTSH Gjirokastër lidhur me transmetimin e dy emisioneve të ankueses;
 - Kopje të kontratave të bashkëpunëtorëve të RTSH Gjirokastër përpara dhe pas emërimit të E. S..
3. Pas seancës dëgjimore, përmes shkresës nr. 471/4 prot., datë 04.07.2023, Komisioneri iu drejtua RTSH Gjirokastër duke kërkuar informacionin si më poshtë vijon:
- Informacion se në cilën periudhë janë transmetuar dy emisionet “Jemi edhe ne” (pa dijeninë e E. S., përse është pretenduar në shkresën kthim përgjigje të RTSH-së).
 - Informacion nëse ka patur më parë bashkëpunime të tjera O. Ç. me QVA Gjirokastër?
 - Informacion, kopje të kontratave dhe të projekteve, të lidhura me bashkëpunëtorë të QVA Gjirokastër, të cilët realizojnë emisione që i përkasin pakicave kombëtare.
 - Informacion nëse pas emërimit të E. S. si drejtues i QVA Gjirokastër janë nënshkruar kontrata me bashkëpunëtor apo janë realizuar emisione që i përkasin pakicave kombëtare? Nëse po, të vihen në dispozicion kontratat e lidhura, projekt-idetë e emisioneve dhe arsimimi i tyre.

Gjithashtu, përmes shkresës së sipërcituar Komisioneri i përcolli ankueses edhe parashtrimet e palës ndaj të cilës është paraqitur ankesa.

Nga ana e RTSH-së Gjirokastër, me anë të shkresës nr. 786/4 prot., datë 25.07.2023, u përcollën informacionet e kërkuara përse më sipër cituar, si dhe u vunë në dispozicion parashtrime shtesë lidhur me çështjen, si më poshtë:

“...Emisioni i pretenduar në këtë ankesë me titull “Jemi dhe ne”, deri në datën 08.03.2023 kur unë jam prezantuar dhe kam nisur punën si drejtori i QVA Gjirokastër, në programet e transmetimeve nuk ekziston ky emision. Gjithashtu, në arkivin e QVA Gjirokastër, nuk ekziston asnjë dokumentacion si psh: marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, autorizim të saj për tu përfaqësuar nga ankuesja, O. Ç., kontratë pune të ankueses, Media Plan, grafik filmimi dhe montazhi për përgatitjen dhe transmetimin e këtij emisioni apo platforma të përbajtjes së tij. Ndërkaq, nuk ka asnjë CV apo informacion të nevojshëm për shkollimin, formimin, apo eksperiencat e mëparshme si gazetarë për të përgatitur emision për Komunitetin Egjiptian.

Në mënyrë të përmbledhur, ju informojmë se, megjithëse ankuesja pretendonte se i kishte kryer këto procedura, krahas verifikimit në arkivin e institucionit, nga ana ime si drejtues i është dhënë

kohë për të paraqitur, qoftë edhe një dokument të vetëm zyrtar për fillimin e emisionit të pretenduar. Por ajo, nuk paraqiti asnjë lloj dokumentacioni ligjor për fillimin e një marrëdhënie pune dhe bashkëpunimi.

Me kërkesë të ankueses, O. Ç. dhe në prezencë të specialistes së Zyrës së Financës dhe Burimeve Njerëzore, M. F., jam takuar me të në datat 10 dhe 14 mars 2023. Shumë qetësisht dhe duke ju referuar rregullave dhe ligjeve, e kemi sqaruar se në arkivin e institucionit nuk kishte të depozituar asnjë nga dokumentacioni i nevojshëm për të nisur bashkëpunimin për emisionin.

Përsa i përket pretendimit se këtë emision për Komunitetin Egjiptian do ta kryente një gazetar i emisionit në gjuhën greke, nuk është aspak i vërtetë. Ankueses i është bërë i ditur se në kuadrin e ndryshimeve programore, është propozuar ngritja e Redaksisë së Diversiteteve që do të thotë se emisionet e minoriteteve do të kenë një vëmendje më të madhe. Emisioni në gjuhën greke, në bisedë është përmendur thjeshtë si një model i mirë dhe aspak siç pretendohet se emisionin e Komunitetit Egjiptian do ta përgatisë një gazetar i emisionit greqisht...”.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, RTSH Gjirokastër vuri në dispozicion kopje të kontratave të bashkëpunëtorëve përpara dhe pas emërimit të E. S..

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, O. Ç., i përket pakicës egjiptiane në Shqipëri. Sipas ankueses, përgjatë muajve janar-mars 2023, ajo ka nisur përgatitjen e emisionit “Jemi edhe Ne” Pakica Egjiptiane, i cili kishte të bënte me prezantimin e kulturës, traditave, zakoneve dhe problemeve me të cilat përballen pakicat egjiptiane.

Më datë 08.03.2023, në RTSH Gjirokastra është prezantuar drejtori i ri i këtij institucioni E. S.. Në momentin e emërimit të tij, ankueses i është ndaluar të hyjë në në ambientet e televizionit dhe të vijojë me përgatitjen e emisionit “Jemi dhe ne”, deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/b, përcakton se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/b/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në listën e shkaqeve të cituara në nenin 1 të LMD-së, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, gjatë procedurave të rekrutimit, apo pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se një person është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- personi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar personin në të drejtën për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e rekrutimit dhe të përzgjedhjes për një vend të lirë pune;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më shumë, nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga pala ankuese, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse O. Ç. i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm gjatë vendosjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit të pretenduara me RTSH Gjirokastrë.

Rregullorja e Brendshme e RTSH Gjirokastrë, që mban nr. 63 prot., datë 11.10.2022, në nenin 17, pika A/1, parashikon detyrat dhe përgjegjësitë e çdo punonjësi, ku ndër të tjera në paragrafin 16 citohet se Drejtori i Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastrë: *“ – Harton dhe përgjigjet për zbatimin e strukturës programore, planin e prodhimit të programeve si dhe transmetimet e tyre. Zbaton planin e transmetimeve të programeve kombëtare audio dhe audiovizive”*.

Në nëndarjen 2, pika 1 të Rregullores, ku citohen ndër të tjera detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeredaktorit, në paragrafin 16, theksohet se: *“Përgatit listprezencat për pagesat e gazetarëve,*

mban shënim orët e punës shtesë, si dhe përgatit Honoraret për bashkëpunëtorët, për ti paraqitur tek zyra e Financës.”

Po në nëndarjen 2, pika 4, parashikohen detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëpunëtorëve, ku në paragrafin e parë, përcaktohet se ata: *“Ideojnë skenarin e emisionit dhe e paraqesin për miratim tek kryeredaktori dhe drejtori i Qendrës Vendore Audiovizive.”*

Referuar provave të administruara, rezulton se ankuesja ka përgatitur së paku 2 (dy) emisione të transmetuara në RTSH Gjirokastra, në datat 11 dhe 17.03.2023, referuar shkresës nr. 786/3 prot., datë 14.07.2023 të RTSH Gjirokastër. Sipas pretendimeve të RTSH Gjirokastër, këto emisione janë transmetuar pa dijeninë dhe miratimin e Drejtorit të saj aktual, E. S. edhe pse këto emisione janë transmetuar pas emërimit të tij. Pavarësisht këtij fakti nga ana e palëve në proces nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë provë apo fakt që ankuesja ka patur një kontratë bashkëpunimi apo ka ideuar skenarin e emisionit dhe e ka paraqitur për miratim tek kryeredaktori dhe drejtori i Qendrës Vendore Audiovizive, siç parashikon Rregullorja e sipërcituar.

Nga ana e ankueses, është pretenduar se ajo ka patur një marrëveshje me ish Drejtorin dhe Kryeredaktoren e RTSH Gjirokastër për realizimin e emisionit *“Jemi edhe Ne”*. Për këtë ankuesja nuk vuri në dispozicion asnjë provë apo fakt që ka patur një marrëveshje bashkëpunimi me subjektet e pretenduara.

Megjithatë, një fakt që vlen të theksohet është mungesa e një dokumentacioni konkret mbi rastin, duke lënë të transmetohet nga strukturat e RTSH Gjirokastra, 2 (dy) emisione pa marrë miratimin e strukturave përgjegjëse dhe në shkelje të parashikimeve të përcaktuara në Rregulloren e sipërcituar.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar, rezulton se gjatë periudhës që ankuesja ka përgatitur emisionet *“Jemi dhe ne”*, pra në janar të vitit 2023, ish Drejtori i RTSH Gjirokastra ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 2 (dy) bashkëpunëtorë, ku 1 (një) prej të cilëve i përket pakicës kombëtare arumune. Ndërsa, edhe Drejtori aktual, pas emërimit⁵ të tij, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 2 (dy) bashkëpunëtorë, ku 1 (një) prej të cilëve i përket pakicës kombëtare greke.

Gjithashtu, rezulton se për periudha 3 (tre), 6 (gjashtë) mujore apo 1 (një) vjeçare, RTSH Gjirokastra ka lidhur kontrata me 12 (dymbëdhjetë) bashkëpunëtorë të cilët kanë realizuar emisione me tematika nga më të ndryshmet.

Në analizë përsa më lart, evidentohet fakti se për realizimin e një emisioni pranë RTSH Gjirokastra, referuar Rregullores së brendshme të saj, nevojitet paraqitja e një skenari të emisionit dhe miratimi nga kryeredaktori dhe drejtori i Qendrës Vendore Audiovizive. Në rastin konkret, nuk u administruan prova për të vërtetuar nëse ankuesja ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi apo

⁵ Më datë 08.03.2023

ka ideuar skenarin e emisionit dhe e ka paraqitur për miratim tek kryeredaktori dhe drejtori i Qendrës Vendore Audiovizive.

Sa i përket pretendimeve të sipërcituara të palës ankuese se emisionin e nisur prej saj do ta realizonte një gazetar i emisionit në gjuhën greke dhe se drejtori i RTSH Gjirokastër i është drejtuar në mënyrë agresive dhe të vrazhdë, ato mbeten deklarative dhe Komisioneri nuk arriti të sigurojë prova të mjaftueshme nga palët për të provuar këto pretendime. Evidentohet se nga të dy palët në proces, pranohet fakti që kanë patur ndërmjet tyre një takim, por sa i përket përmbajtjes së çfarë është diskutuar, nuk u arrit të provohej prej tyre.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm, si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, O. Ç., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastër, lidhur me moslejimin e realizimit të emisionit “Jemi edhe ne” Pakica Egjiptiane. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e subjektit kundër të cilit pala ankuese ka paraqitur ankesën, Qendra Vendore Audiovizive Gjirokastër.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të O. Ç., në të drejtën për punësim, për shkak të racës, ngjyrës dhe etnisë, nga ana e Qendrës Vendore Audiovizive Gjirokastër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca, ngjyra dhe etnia)

(Fusha: Punësim)